




Operatori i Sistemit të Transmetimit



Të nderuar miq,

Viti 2015 ka qenë një vit i rëndësishëm për sektorin elektroenergjetik shqiptar në përgjithësi, por edhe për Operimin e sistemit të Transmetimit (OST) në veçanti, si në ndër pjesëtarët kryesorë të këtij sektori. OST sh.a. ka vijuar të përmbushë detyrimet e veta ligjore, duke garantuar kapacitetet e nevojshme për furnizimin me energji elektrike të tregut të brendshëm, si dhe duke realizuar volume të konsiderueshme shkëmbimesh në tregun rajonal të energjisë. Përgjatë atij viti OST sh.a. realizoi 100% transmetimin e energjisë elektrike për të përballuar konsumin e brendshëm në nivelin 7.473 TWh, nga të cilat 4.406 TWh nga prodhimi i brendshëm dhe 3.067 TWh import nga tregu rajonal i energjisë elektrike.

Një ndër fushat që i është kushtuar kujdes i veçantë ka qenë edhe realizimi i projekteve që ose kanë përfunduar, ose janë në fazën e implementimit, si dhe interesimi i vazhdueshëm për sigurimin e burimeve të nevojshme financiare nga institucionet përkatëse për të financuar projektet e reja për fuqizimin, përsosjen dhe zhvillimin sipas standardeve bashkëkohore të sistemit të transmetimit.

Në atë vit u punua intensivisht për të realizuar disa projekte shumë të rëndësishme që ndikuan në ecurinë e punës në vitet që pasuan. Me përparësi u ndoq puna në linjën e interkonjeksionit 400 KV Shqipëri-Kosovë, që ajo të përfundohej në kohë dhe të vihej në punë në fillim të vitit 2016.

Ndërkohë gjatë vitit 2014 elemente të veçantë për përf forcimin e rrjetit të transmetimit 110 KV të Jugut të Shqipërisë në fund të viti 2015, kanë përfunduar dhe janë në gjendje pune të plotë. U punua me shumë ngulm për ndërtimin e Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrave Qendrore të OST dhe u arrit që ar orë përfundonin brenda parashikimit, dhe u vu në funksion të plotë sistemi SCADA/EMS.

OST sh.a. po vijon punën për sigurimin e financimit për disa projekte të tjera të rëndësishme, që do të vijnë të përmirësojnë cilësinë e shërbimit dhe besueshmërisë për sistemin e transmetimit për vitet në vijim. Vlen të përmenden projekte të tilla si: linja 220 KV me dy qarqe, ‘Tirana 2 Rashbull’ dhe fuqizimi i Nënstacionit të Rashbullit; përforcimi i Rrjetit Unazor 110 KV të Tiranës dhe ndërtimi i nënstationit të ri 400/110 KV ‘Tirana 3’: linja e interkonjeksionit 400 KV Maqedoni-Shqipëri dhe zgjerimi i nënstationit 400 KV ‘Elbasan 3’, si dhe linja e transmetimit 400 KV Elbasan 2-Fier dhe zgjerimi i nënstationit të Fierit.

Viti 2014 ka qenë vit shumë i rëndësishëm për procesin e anëtarësimit të plotë të OST sh.a. në ENTSO – E. Më 10 dhjetor 2014, OST sh.a nënshkroi në Bruksel marrëveshjen afatgjatë për operimin sinkron të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar me sistemin e Evropës Kontinentale. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bëri të mundur që OST sh.a. të jetë pjesëmarrëse me specialistët e saj në të gjitha nivelet e përfaqësimit të ENTSO-E.

Në sajë të punës së bërë, OST sh.a., do të vijojë të jetë një kompani lider në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe për vitet në vijim, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore dhe teknike, duke garantuar përdoruesit e Sistemit të Transmetimit që do të kenë gjithmonë një shërbim cilësor dhe me standarde bashkëkohore evropiane.

Me respekt dhe mirënjohje,

Dr.Ing. Engjëll Zeqo,
Administrator i OST sh.a.



Përmbajtja

06

I. Prezantimi i OST sh.a.

12

II. Modeli i drejtimit të OST sh.a.

16

III. Drejtimi operativ i sistemit

27

IV. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të transmetimit

36

V. Operatori i tregut

44

VI. Planifikimi dhe zhvillimi i sistemit të transmetimit

52

VII. Pasqyrat financiare

raport 2015

I. PREZANTIMI I OST sh.a.


1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit.


Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë

afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.


Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania mbështetet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.



Në mënyrë të përmblodhur përgjegjësitë kryesore të OST sh.a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi janë:



2. VIZIONI, MISIONI, PËRPARËSITË DHE STRATEGJITË



VIZIONI



Të zhvillojë sistemin e transmetimit, me qëllim për të përmbushur kërkesën aktuale dhe të ardhshme për energji elektrike në tregun vendas e rajonal.

MISIONI



OST sh.a. është një kompani, që siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, bazuar në standardet, arritjet dhe praktikatat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO- E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe shkëmbim të sigurt dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.



PËRPARËSITË DHE STRATEGJITË

Zhvillimi i sistemit të transmetimit në përputhje me pritshmëritë, dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike si një e tërë.

- Sigurimi i kushteve të përshtatshme të operimit të tregut të energjisë elektrike në përputhje me zhvillimet e pritshme të tregut.
- Funksionimi me efektivitet dhe efikasitet për ruajtjen dhe garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik shqiptar.
- Sigurimi i stabilitetit financiar të kompanisë.
- Bashkepunimi i ngushtë me Entin Rregullator të Energjisë, për të siguruar një model transparent dhe konkurrues të tregut të energjisë elektrike.
- Sigurimin e mjedisit punëdhënës atraktiv në tregun e punës në Shqipëri.
- Respektimi i të gjitha politikave mjedisore në përputhje me standardet europiane në menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

OST sh.a. është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së saj teknike, ekonomike dhe financiare, për të përmbushur standardet më të mira ndërkombëtare të Komunitetit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe të organizatave europiane, të cilat nxisin dhe monitorojnë hapjen e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal dhe europian të energjisë. OST sh.a. ka nënshkruar me të gjithë OST-të, anëtare të ENTSO-E, marrëveshjen LTA (Long Term Agreement), duke bërë kështu një hap përpara drejt anëtarësimit të saj të plotë në këtë organizatë. Në përputhje me parashikimet e LTA, OST sh.a. ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha strukturat e organizmit teknik të ENTSO-E, përfaqësuar nga ekspertët përkatës si dhe në Asamblenë e Përgjithshme të ENTSO-E (pa të drejtë vote). Shqipëria është një ndër vendet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me zhvillimin rajonal të sektorit të energjisë elektrike, dhe të gazit natyror në Evropën Juglindore. Ky traktat u kërkon vendeve anëtare dhe vendit tonë që të përafrojnë dhe të përshtatin kuadrin ligjor me *acquis communautaire* të BE-së në katër fusha, duke përfshirë

direktivën për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe të rregullores për shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet vendeve fqinje.

OST sh.a. është një prej shoqërive themeluese të SEE CAO (South East Europe Capacity Allocation Office) së bashku me shoqëritë e transmetimit të Malit të Zi, Kroacisë, Greqisë, Kosovës, Bosnje Hercegovinës dhe Turqisë.

Që prej vitit 2015 SEE CAO zhvillon, procesin e ankandëve të kapaciteteve të interkonjeksionit me bazë vjetore, mujore dhe ditore. Duhet theksuar se aktualisht për shkak të mosnjohjes së Kosovës si zonë rregulluese ankandet e kapaciteteve mujore dhe ditore për kufirin me Kosovën zhvillohen nga vetë OST.

SEE CAO është një provë reale e përpjekjeve të bashkëpunimit rajonal ndërmjet OST-ve të rajonit, dhe krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e tregut të përbashkët të energjisë në rajon.

Ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” nr. 43/2015, ashtu sikurse edhe anëtarësimi i pritshëm së shpejti me të drejta të plota në ENTSO-E, e vendos OST-në përballë një perspektive të re, e cila kërkon përshtatjen e sektorit elektroenergjetik ndaj tregut të energjisë dhe si rrjedhojë; edhe OST-në me modelet europiane.

3. ÇËSH TJET MJEDISORE

OST-ja e vlerëson ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si një prej detyrave të saj me përparësi dhe është vazhdimisht duke punuar për të përmirësuar performancën mjedisore të kompanisë. OST-ja ka hartuar dhe zbaton tashmë politika mjedisore që janë publikuar në faqen e internetit të kompanisë. Zbatimi i politikave

të mjedisit realizohet nëpërmjet Planeve të Veprimit, të cilat detajojnë të gjitha aspektet e identifikuara mjedisore. Politika e OST-së për mjedisin mbështetet në tre shtylla kryesore:

a) Menaxhimi i çështjeve mjedisore të OST-së është, zhvilluar në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat mjedisore të energjisë elektrike.

OST sh.a. zbaton legjislacionin mjedisor për të gjitha projektet që në fazën e parë të projektimit, gjatë zbatimit si dhe pas realizimit të projekteve. Çdo projekt është në përputhje me:

- Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", mbi parandalimin dhe marrjen e masave për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe cilesisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar me ligjin 12/2015 duke siguruar për çdo projekt një Deklaratë Mjedisore/Vendim për VNM Paraprake në varësi të llojit të projektit dhe shtrirjes së tij.

OST sh.a. merr të gjitha masat për zbatimin e legjislacionit për pyjet e kullotat në rast se projekti kalon në sipërfaqet pyjore e kullimore duke bërë të mundur sigurimin e të gjitha dokumentacioneve të nevojshme

b) Përmirësimi i performancës mjedisore, nëpërmjet sensibilizimit të përshtatshëm të stafit dhe trajnimet përkatëse për këtë çështje;

c) Parandalimi dhe zbutja e ndikimeve mjedisore, monitorimin e kontrollin e shkarkimit dhe ndotjen brenda standardeve të pranueshme për të menaxhuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.

- Për të gjitha projektet hartohet një raport paraprak i "Vlerësimit të ndikimit në mjedis" në të cilin përshkruhen dhe vlerësohen efektet direkte dhe indirekte të projektit te njerëzit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terrenin dhe ndërtimi i tij dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgiminë kulturore, shoqërore dhe mjedisore. Me vlerësimin e efekteve që mund të shkaktohen në mjedis, hartohen masat e nevojshme që duhet të merren për parandalim apo eliminim e ndikimeve negative në mjedis.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ndikimet negative që mund të shkaktohen si pasojë e zbatimit të projekteve.
- Zbatohen të gjitha kushtet mjedisore të vendosura në Deklaratën Mjedisore apo Vendimin për VNM Paraprake duke marrë masat për të shmangur, reduktuar apo pakësuar të gjitha ndikimet e padëshirueshme në mjedis.
- Kryhen monitorime/inspektime në terren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesit gjatë realizimit të projekteve si dhe gjatë funksionimit të tyre.
- Rehabilitimi i sipërfaqeve të prekura apo të dëmtuara nga projekti si dhe rimbjellja e këtyre sipërfaqeve pyjore, duke u bazuar në legjislacionin e pyjeve për të bërë të mundur përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Në bazë të politikave të mjedisit, menaxhimi ka caktuar objektivat mjedisore të kompanisë mbi ndikimet mjedisore që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë. Një bazë e fortë për menaxhimin e çështjeve mjedisore është Sistemi i Menaxhimit Mjedisor në përputhje me standardin europian ISO 14001.

iStock
by Getty Images™

iStock
by Getty

Stock
by Getty Images™

iStock
by Getty Images™

iStock
by Getty Images™

iStock
by Getty

raport 2015

II. MODELI I DREJTIMIT TË OST sh.a.

1. STRUKTURAT DREJTUESE

OST sh.a. DREJTOHET NGA:

- **Këshilli Mbikëqyrës**
- **Administratori**

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Në 31 dhjetor 2015, Këshilli Mbikëqyrës përbëhej nga:

PAJTIM BELLO
kryetar

ILIR BEJTJA
anëtar


NIKOLLA LERA
anëtar


EVIS KOPLIKU
anëtar

ARBEN DHIMO
anëtar

DIANA DERVISHI
anëtar

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. ka emëruar z. ENJËLL ZEKO, Administrator të OST sh.a.






2. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE


Struktura e organizimit të OST-së është e thjeshtë dhe e ndryshueshme duke krijuar mundësinë e përmirësimeve të mëtejshme dhe krijimin e hallkave të reja (nëse lind nevoja) në bazë të kësaj strukture. Numri mesatar i punonjësve të OST-së për vitin 2015 ka qenë 732 punonjës. Stafi i OST-së është i motivuar dhe i aftë për të përmbushur synimet strategjike si dhe të ndjekë e zbatojë projektet e reja në kohë e me sukses të plotë. Për përmbushjen e detyrimeve që vijnë si rezultat i respektimit të standardeve ligjore, si dhe i kërkesave të anëtarësimit në ENTSO-E,

OST sh.a. ka rritur kërkesat për angazhim në punë të stafit të ri të kualifikuar dhe të aftë. Politikat e burimeve njerëzore mbulojnë planifikimin e rekrutimeve të burimeve njerëzore duke synuar përzgjedhjen dhe emërimin e punonjësve nëpërmjet procedurave sa më transparente dhe konkurruese, zhvillimin e një sistemi karriere bazuar në aftësitë profesionale, menaxhimit të performancës dhe shpërblimet, si dhe zhvillimin e aftësive personale pa diskriminim për shkak të moshës, paaftësive fizike, origjinës, racës, besimit fetar, seksit, etj.

ADMINISTRATA QËNDRORE




NJËSITË PËRBËRËSE




*Personeli sipas moshës

ADMINISTRATA QËNDRORE



NJËSITË PËRBËRËSE




*Raporti gjinor i personelit

raport 2015


III. DREJTIMI OPERATIV I SISTEMIT

OST sh.a. operon sistemin e elektroenergjetik me anë të sistemit të menaxhimit të energjisë elektrike, duke marrë parasysh sigurimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.



bilanci energjistik për vitin 2015

PËRSHKRIMI	NJËSIA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
Sasia e përgjithshme e energjisë që hynë në sistemin e OST	GWh	745	772	809	694	761	534	611	615	538	508	559	685	7,830
Prodhimi vendas	GWh	477	669	667	626	680	382	392	383	339	205	296	358	5,475
Energjia në marrje	GWh	267	103	142	68	81	153	219	232	199	302	263	327	2,355
Sasia e përgjithshme e energjisë së transmetuar	GWh	730	756	792	678	743	523	598	602	528	499	549	673	7,672
Energjia e transmetuar për OSHEE	GWh	644	549	545	462	430	440	521	519	448	445	489	614	6,106
Energjia e transmetuar për klientët e kualifikuar	GWh	36	32	54	50	82	58	48	59	58	40	48	46	610
Humbjet në rrjetin e transmetimit + Nevojat vetiake	GWh	14	16	17	16	18	11	14	12	10	9	10	11	159
Humbjet në rrjetin e transmetimit në %	%	1,94	2,06	2,06	2,31	2,40	2,10	2,21	2,02	1,89	1,75	1,75	1,66	2,03






Në lidhje me Drejtimin Operativ të Sistemit, OST është përqendruar në përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të Sistemit të Transmetimit në aspektin e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë së punës së sistemit, e lidhur kjo ngushtësisht me drejtimin operativ të SEE në tërësi, në zbatim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Modelit dhe Rregullave të Tregut në Shqipëri.

1. PRODHIMI, SHKËMBIMI DHE KONSUMI


Hidrocentralet dominojnë sektorin e gjenerimit të vendit dhe prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri është shumë i varur nga kushtet hidrologjike për gjatë gjithë vitit, duke variuar afërsisht nga 3 TWh në një vit të thatë, në 7 TWh në një vit me lagështirë. Ky ndryshim i madh i prodhimit në vitet e thata dhe në vitet e lagështa, e ul besueshmërinë e sistemit gjenerues dhe kërkon domosdoshmërisht sigurimin e energjisë elektrike nga importi për të plotësuar kërkesën e vendit për energji elektrike.

OST aktualisht operon sinkron me rrjetin e transmetimit evropian ENTSO-E nëpërmjet linjave të interkonjeksionit me vendet fqinje të tensionit 400 kV dhe 220 kV. Në janar të vitit 2015 u nënshkrua Marrëveshja e Operimit LTA (Long Term Agreement) për Operimin Sinkron me rrjetin e transmetimit Evropian ENTSO-E, nëpërmjet të cilës vendi ynë ka statusin e anëtarit me të drejta të plota të këtij grupimi të rrjeteve nacionale të Transmetimit të vendeve europiane, ENTSO-E.

Për të mbuluar kërkesën për energji elektrike, Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar është bërë një importues neto i energjisë elektrike, për rreth dy dekada, me përjashtim të vitit 2010, ku shkëmbimi neto rezultoi në 732 GWh në drejtimin eksport, si rrjedhojë e prurjeve të bollshme në kaskadën e Drinit, që ishin rreth dy herë më të larta së niveli i prurjeve mesatare shumëvjeçare. Në tabelën e mëposhtme paraqitet prodhimi, konsumi dhe shkëmbimet gjatë këtyre viteve:



*Prodhimi, shkëmbimi dhe konsumi në periudhën 1998-2015




* Të dhënat e vitit 2015 me bazë mujore

Viti 2015 konsiderohet si një vit normal lidhur me temperaturat e mjedisit dhe parametrat kryesorë energjetikë të sistemit tonë. Konsumi i përgjithshëm rezultoi 6.874 TWh, ku 5.475 TWh u gjeneruan nga prodhimi i vendit dhe 1.399 TWh u importuan. Prurjet në kaskadën e Drinit, në pranverë dhe në vjeshtë, rezultuan

pak më shumë se prurjet e parashikuara (mesatare llogaritëse), gjë që ndihmoi në mbajtjen e niveleve relativisht të larta në ujëmbledhësit e kaskadës, e si rrjedhim edhe në disponibilitetin e një rezerve energjetike të mjaftueshme.

Përgjithësisht, konsumi i energjisë elektrike ishte në linjë me vlerat e parashikuara në planifikimin vjetor, ku mund të vihet re një ulje e ndjeshme e konsumit të përgjithshëm të vendit (rreth 10% më pak krahasuar me një vit më parë), si rrjedhojë e masave të marra nga Qeveria dhe OSHEE sh.a. për uljen e humbjeve joteknike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e nivelit të arkëttimeve.

Gjatë vitit 2015 nuk jemi ballafaquar me avari të rënda, apo ngjarje të paparashikuara të shoqëruara me ndërprerjen apo kufizimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve të vendit.



Një balancë e qëndrueshme ndërmjet prodhimit dhe konsumit, është parakusht për një Sistem të Qëndrueshëm që garanton sigurinë e furnizimit me frekuencën e vendosur prej 50 Hz. Kjo nënkupton që prodhimi dhe konsumi duhet të koordinohen në mënyrë të tillë që të ruhet balanca e kërkuar.

Operimi i Përditshëm i Sistemit përfshin harmonizimin (ruajtjen e balancës) ndërmjet gjenerimit dhe konsumit, në kohë reale dhe në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe ruajtjen e tensionit dhe frekuencës brenda nivelit të lejuar.

Si rrjedhojë e vënies në punë të rregullimit sekondar AGC-LFC në të tre centralet e KESH-it dhe kujdesit të treguar nga operatorët tanë, ka pasur një rritje cilësore të mbajtjes nën kontroll të devijimeve.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet kurba e vazhdimësisë së ngarkesës së regjistruar të vendit, nga ku duket se për rreth 1100 orë në vit ngarkesa e konsumit të vendit është e rendit mbi 1000 MW.

Kurba e vazhdimësisë së ngarkesës

2015 1600

1400
1200
1000
800
600
400
200
0

1 1001 2001 3001 4001 5001 6001 7001 8001

Orët gjatë vitit

A. MENAXHIMI I SISTEMIT DUKE SHFRYTËZUAR SISTEMIN SCADA/EMS

Në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, OST sh.a. është implementuar platforma e menaxhimit të rrjetit energjetik: “Network Manager”. Kjo platformë ofron të gjithë funksionalitet e SCADA/EMS (Supervisory Control and Data Acquisition / Energy Management System), si dhe një sërë funksionesh të tjera. Gjatë vitit 2015 kjo platformë ka qenë në operim të plotë. Aplikacionet e “Network Manager” përdoren gjithashtu për kryerjen e kontrolleve dhe analizave në kohë reale, si dhe për qëllime optimizimi e planifikimi. Këto mjete të fuqishme të operimit të rrjetit na ofrojnë lehtësi e operim të dobishëm ditor.

Krahas platformës “Network Manager”, në OST sh.a. është e implementuar edhe platforma “e-terra” e cila shërben si sistem backup për Qendrën Kombëtare Dispeçer. Nëpërmjet këtij sistemi monitorohen dhe kontrollohen Nënstacionet 400 kV dhe 220 kV. Krahas Nënstacioneve në sistemin “e-terra” monitorohen dhe operohen në kuadrin e LFC edhe centrale të KESH sh.a. Vënia në punë e operimit nga ana e LFC të centraleve u mundësua nga implementimi i projektit “Linja 400 kV Tirana 2 Kosova B”, ku një ndër objektet e projektit ishte implementimi i LFC në Sistemin Backup të OST sh.a. dhe kontribuimi në mënyrë automatike në rregullimin sekondar të KOSTT, nëpërmjet sistemeve SCADA.

SCADA (SUPERVISORY CONTROL AND DATA ACQUISITION)

Në sistemin e kontrollit të implementuar në OST sh.a. monitorohen dhe operohen në kohë reale të gjithë nënstationet 220/400kV, si dhe pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e nënstationeve 110kV. Ndër funksionet kryesore që ofron moduli SCADA i “Network Manager” është :

- Grumbullimi i të dhënave nga nënstationet dhe monitorimi i tyre nga Qendra Kombëtare Dispeçer në kohë reale.
- Monitorimi i të dhënave kryesore të sistemit të Transmetimit të KOSTT nëpërmjet linjës së dedikuar të komunikimit. Ndër këto të dhëna përfshihen të gjithë të dhënat në kohë reale të nevojshme për mundësimin e Rregullimit Sekondar edhe për Zonën e KOSTT si dhe disa të dhëna kryesore të

nënstacioneve kufitare.

- Përveç monitorimit të nënstacioneve të OST sh.a. dhe pjesës më të madhe të nënstacioneve të OSHEE, në Qendrën Kombëtare Dispeçer monitorohen edhe nënstacione kryesore të Malit të Zi CGES (Montenegrin Control Center) si dhe të Greqisë, IPTO (Greek Control Center). Monitorimi i këtyre nënstacioneve kufitare, (CGES, IPTO), mundësohet duke shfrytëzuar rrjetin Electronic Highway, rrjet i mbyllur ndërmjet OST-ve.
- Venia në dispozicion e të dhënave të Nënstacioneve 400kV/220kV të OST sh.a. për rrjetin Electronic Highway. Këto të dhëna mund të monitorohen nga të gjithë OST-të e lidhura në këtë rrjet privat.

Në kuadër të monitorimit në kohë reale nëpërmjet sistemit SCADA, si dhe në zbatim të kodit të Rrjetit të Transmetimit gjatë vitit 2015 sistemi SCADA është zgjeruar duke përfshirë në të disa centrale private. Krahas platformës kryesore SCADA “Network Manager” gjatë këtij viti OST sh.a. ka zgjeruar sistemin backup SCADA duke e plotësuar atë me të gjithë nënstacionet 400kV/220kV.

MONITORIMI DHE ECURIA E NGJARJEVE:

- Supervizimi, kontrolli dhe komandimi nga qendra dispeçer;
- Arkivimi i të dhënave dhe i ngjarjeve;
- Llogaritje dhe raporte të dhënash;
- Ndërfaqe grafike ndërmjet përdoruesit dhe “Network Manager”.

EMS (ENERGY MANAGEMENT SYSTEM)

EMS është paketa e aplikacioneve të rrjetit, e cila nëpërmjet studimeve të brendshme të sistemit, bazuar në gjendjen aktuale të tij dhe në parametrat e çdo elementi të sistemit energjetik të përfshirë në SCADA, optimizon gjendjen e sistemit. Ky modul përbëhet nga disa aplikacione, të cilat bashkëveprojnë në rrjet me njëra-tjetrën, dhe në të njëjtën kohë mund të menaxhohen veçmas nga njëra tjetra. Ndër aplikacionet kryesore të rrjetit të implementuara në “Network Manager”, mund të përmendim “State Estimator” i cili bën një vlerësim të përgjithshëm të sistemit energjetik në gjendje të qëndrueshme si dhe “Security Analysis” që kryhen analizat e sigurisë së rrjetit energjetik.

AUTOMATIC GENERATION CONTROL (AGC)

Kontrolli automatik i gjenerimit është moduli, që rregullon në mënyrë automatike prodhimin e gjeneratorit, që të mbajë frekuencën dhe shkëmbimin në vlerat e skeduluara. Gjatë vitit 2015 ky modul ka qenë në shfrytëzim të vazhdueshëm, duke pasur nën kontroll tre hidrocentralet më të mëdha të Shqipërisë (Fierzën, Komanin, Vaun e Dejës). Siç kemi përmendur edhe në paragrafet e mësipërm, gjatë këtij viti, OST sh.a. në bashkëpunim me KOSTT kanë implementuar projektin mbi rregullimin sekondar, projekt sipas të cilit OST sh.a., mundëson kontributin në rregullim e KOSTT duke shfrytëzuar rezervën e rakorduar me KESH sh.a. në këtë kuadër.

FUNKSIONE TË TJERA TË IMPLEMENTUARA NË PAKETËN “NETWORK MANAGER”

Veç moduleve kryesore të përmendura më sipër, në “Network Manager” janë përfshirë edhe funksione të tjera, të cilat ndihmojnë në operimin sa më eficient të qendrës së kontrollit dispeçer. Ndër funksionet më kryesore të përfshira janë:

- **LOAD SHEDDING** është një tjetër funksion i implementuar në “Network Manager”, me anë të të cilit është e mundur të çkyçen në mënyrë automatike disa elemente të caktuara të rrjetit energjetik, në rastet kur kërkesa për energji është më e madhe së gjenerimi i disponueshëm.
- **STLF (SHORT TERM LOAD FORECAST)** është aplikacioni, i cili, duke u bazuar në të dhënat statistikore dhe në parashikimet e temperaturave, kryen një parashikim mbi ngarkesën e sistemit energjetik për një kohë të shkurtër, për 15 ditë.
- **CF (CONGESTION FORECAST)** është një instrument për të bërë analizën e gjendjes së rrjetit energjetik në të ardhmen.

B. NDËRFAQËSIMI ME ENTSO-E

OST sh.a., duke qenë pjesë e Rrjetit të Transmetimit Evropian dhe për t'i përmbushur standardet e ENTSO-E, ka përmbushur detyrimet lidhur me ndërfaqësimin me OST-të e tjera, si dhe me vetë ENTSO-E. Në këtë kuadër, OST sh.a. ka implementuar të gjithë kërkesat për të qenë pjesë zyrtare e "Electronic Highway", si dhe ka iniciuar procesimin e të dhënave të nevojshme për Platformën e Transparencës së ENTSO-E. Electronic Highway (EH) është një rrjet i dedikuar i mbyllur ndërmjet OST-ve të Europës. Nëpërmjet këtij rrjeti shkëmbehen të dhëna në kohë reale, si dhe në kohë joreale. OST sh.a., duke iu përmbajtur direktivave të ENTSO-E ka implementuar njërin e rrjetit të instaluar në nënstacionet "Tirana 2", në Qendrën Kombëtare Dispeçer. Linjat e komunikimit për rrjetin EH janë:

- **IPTO Greqi: Leased Line 10 mbps, PtP**
- **CGES Mal i Zi: Private Line over SDH Network 10 mbps, PtP**

Shërbimi i shkëmbimit të të dhënave në kohë reale dhe joreale është implementuar me Malin e Zi, dhe me Greqinë. Krahas monitorimit dhe transferimit të të dhënave në rrjetin Electronic Highway, gjatë vitit 2015, OST sh.a. duke shfrytëzuar këtë rrjet, ka realizuar komunikimin në kohë reale me nyjen qëndrore të sistemit "ENTSO-E Awareness System" RTE-Francë, duke i dërguar këtij sistemi të dhënat kryesore të rrjetit të transmetimit të OST sh.a. EAS është një platformë ku kanë akses të gjithë OST-të dhe në të publikohen të dhëna reale mbi gjendjen aktuale të sistemeve të Transmetimit të Evropës. Gjatë këtij viti OST sh.a. është bërë pjesë zyrtare e EAS.

C. SISTEMET/PAJISJET LOKALE TË KONTROLLIT

Sistemet SCADA furnizohen me të dhëna në kohë reale nga pajisjet RTU dhe/apo nga sisteme lokale të monitorimit të instaluar nëpër Nënstacione. Transferimi i këtyre të dhënave mundësohet nga rrjeti i Telekomunikacionit të OST sh.a. nënstacionet 400kV/ 220kV janë të gjitha të pajisura me sisteme lokale kontrolli si dhe pjesërisht me RTU për mundësimin e të dhënave nëpërmjet dy burimeve. OST sh.a., gjithashtu ka të instaluar RTU në shumë Nënstacione 110kV. Gjatë vitit 2015 ka patur zhvillime edhe në kuadër të këtyre sistemeve lokale të kontrollit/RTU-ve. Ndër këto mund të përmendim:

- Instalimi i pajisjeve RTU në nënstacionet e Sarandës, Përmetit dhe Korçës. Aktualisht këto pajisje mbledhin të dhëna nga elementet e nënstacioneve respektive.
- Implementimi i sistemit të ri të Kontrollit në nënstacionin e Zemblakut dhe integrimi i tij në sistemin SCADA të Qendres Kombëtare Dispeçer.
- Integrimi i RTU-të në KOMAN, FIERZË dhe VAU DEJËS në sistemin Backup SCADA duke mundësuar kështu edhe kontrollin nga ky sistem të këtyre nënstacioneve.

Po në këtë vit u krijua Zyra e Kontroll Monitorimit dhe Automatikes, që është përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve / pajisjeve të kontrollit në nënstacione. Gjatë këtij viti janë kryer disa zhvillime në kuadër të këtyre sistemeve/pajisjeve.

D. PLATFORMA E OPERIMIT TË SISTEMIT DHE E OPERIMIT TË TREGUT

Gjatë vitit 2015, është filluar një investim i rëndësishëm në kuadër të menaxhimit të operimit të sistemit dhe të tregut. Nëpërmjet këtij investimi do të realizohet që operimi i sistemit dhe i tregut të kryhet në mënyrë automatike nëpërmjet një platforme bashkëkohore. Platforma në fjalë do të menaxhojë një sërë procesesh të ndërlidhura me njëra tjetrën. Ndër këto procese mund të përmendim :

- Alokimi i kapacitetit ndërkufitar.
- Llogaritja e energjisë në kufi.
- Nominimi, skedulimi dhe rakordimi i tij me palët kufitare dhe me qendrën koordinative të rajonit.
- Mekanizmi i balancimit.
- Shërbimet ndihmëse.
- Platforma e transparencës.

Kjo platformë, tashmë e projektuar, do të jetë e aksesueshme edhe nga pjesëmarrësit e Tregut. Platforma është e bazuar në Web dhe është projektuar konform të gjitha standardeve të sigurisë si dhe duke marrë parasysh plotësimin e kërkesave të ENTSO-E.

2. DISPEÇERIMI

Gjatë vitit 2015, Dispeçeria ka realizuar drejtimin operativ të punës së bashkërenduar të centraleve elektrike, rrjetit të transmetimit dhe nënstacioneve deri në ndërfaqen me Sistemin e Shpërndarjes. Viti 2015 ka qenë një vit i ngarkuar për të plotësuar detyrat parësore të Dispeçerisë Qendrore, si: mbajtja e balancës në SE; krijimi i kushteve për kryerjen e remonteve nga Njësitë Operative të Transmetimit; eliminimi i avarive dhe defekteve në kohën më të shkurtër të mundshme; komunikimi në mënyrë profesionale me personelin operativ të TSO-ve fqinje; skedulimin e programit të shkëmbimit sipas formatit të përcaktuar në politikën e dytë të Manualit Operacional të ENTSO-E etj.



Gjatë këtij viti përveç remonteve të planifikuara nga Njësitë Operative të OST-së, eliminimit të avarive e defekteve në SE, operatorët kanë qenë mjaft të angazhuar me kryerjen e veprimeve operative për të krijuar kushtet e punës për kontraktorët dhe nënkontraktorët e OST sh.a. në implementimin e shumë projekteve për shtrirjen e linjave të reja 110 kV (Unaza e Jugut), fuqizimin e nënstacioneve (Zëmblak, Korçë), si dhe shtrimin e fibrës optike (OPGW) dhe vijimin e punimeve për linjën 400kV Tirana2-Kufi (KosovaB).

3. KONTROLI I ZBATIMIT TË KODIT TË RRJETIT NGA PËRDORUESIT

Gjatë vitit 2015 është kryer kontrolli periodik dhe mbikëqyrja e përdoruesve kryesorë të rrjetit të transmetimit për të verifikuar parametrat e operimit, plotësimin e kërkesave të lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe janë propozuar masat teknike përkatëse që duhen marrë në rast të shmangieve nga kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

Për sa i përket kontrollit dhe mbikëqyrjes së Përdoruesve (Njësitë Gjeneruese, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Konsumatorët e Kualifikuar), janë verifikuar parametrat e operimit dhe pajtueshmëria me kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, sipas një plani pune me bazë vjetore; por edhe kontrole sipas rastit për ata Përdorues të Rrjetit të Transmetimit, që nuk kanë zbatuar me përpikmëri udhëzimet e Qendrës Kombëtare Dispeçer.

Sipas rastit janë bërë interpretime të ndryshme lidhur me klauzolat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, kur është kërkuar nga Përdoruesit e Rrjetit si dhe janë përgatitur propozime për rishikimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

Specialistët e OST sh.a. kanë marrë pjesë në testimin e njësive gjeneruese për të verifikuar përputhshmërinë e parametrave teknike të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe ato të dakordësuara me OST sh.a. lidhur me pajisjet dhe sistemet teknologjike të tyre të instaluar.

Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2015 që mund të përmenden janë si vijon:

- Hartimi i draftit të ri të Kodit të Rrjetit të Transmetimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe në pajtueshmëri me dispozitat e Kodeve të Rrjetit dhe Manualit Operacional të ENTSO-E, kuadrin rregullator dhe angazhimin e Shqipërisë për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, si dhe bashkëpunimin rajonal në kuadër të krijimit të tregut të përbashkët evropian të energjisë elektrike.
- Hartimi i “Rregullave të Cilësisë së Furnizimit dhe Performacës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit”.
- Hartimi i “Rregullores dhe Procedurave të Blerjes së Shërbimeve Ndihmëse dhe Prokurimit të Humbjeve të Energjisë Elektrike në Rrjetin e Transmetimit” etj.
- Pjesëmarrja dhe plotësimi i anketimit në lidhje me Politikën 5 “Operacionet e emergjencës” i Manualit Operacional të ENTSO-E për të cilën OST sh.a. do të auditohet në vitin 2016 mbi përmbushjen e standardeve të kësaj politike.
- Komunikimi aktiv dhe kontributi në hartimin, shqyrtimin dhe finalizimin e një sërë aktesh për plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

4. PLANIFIKIMI I REGJIMIT TË PUNËS (PLANIFIKIMI OPERACIONAL)

Bazuar në Kodin e Rrjetit dhe Rregulloren e Punës të DDO, OST sh.a. ka kryer një sërë veprimtarish në lidhje me Regjimin e Punës së SE gjatë vitit 2015, ku ndër të tjera mund të përmendim:


- Kryerja e llogaritjeve për remontet e kërkuara për çdo element të sistemit të prodhim-transmetimit, dhe përcaktimi i masave që duhet të merren në çdo rast, për të ruajtur sigurinë e punës dhe nivelin e tensioneve brenda normës.
- Plotësimi i bazës së të dhënave me ngarkesat dhe treguesit e tjerë të sistemit, përgatitja e tabelave dhe grafikëve të dinamikës së prodhimit, konsumit, shkëmbimit, kuotës në Fierzë dhe rezervës së kaskadës së Drinit.
- Gjatë vitit 2015, është realizuar telekonferenca javore me pjesëmarrësit e grupit, ku palët njoftojnë reciprokisht mbi situatën në Sistemin e Transmetimit (skema e rrjetit, ngarkesat, stakimet e ndryshme, temperatura e motit, piku i ngarkesës etj).
- Kryerja e simulimeve dhe llogaritjeve të ndryshme me anë të softit “TNA Analyzer”, si p.sh., llogaritja e NTC, studimi i qëndrueshmërisë statike të SE, por edhe të atij të Europës Juglindore (SEE), si dhe krijimi i modelit mujor në avancë M+2 (krijohet për orën 10:30 të mërkurës së tretë të muajit).
- Është bërë përgatitja e materialeve për web-site e OST (grafiku ditor i ngarkesës i realizuar, tabela mbi skedulimet finale në linjat e interkonjeksionit dhe mbi kapacitetet e lira në interkonjeksion, për t’u përdorur si skedulim intraday në bashkëpunim me grupin e skedulimit).

raport 2015

IV. SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRJETIT TË TRANSMETIMIT

OST sh.a. punon në vazhdimësi për të mirëmbajtur dhe zhvilluar Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, në përputhje me parashikimin afatgjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimeve të reja gjeneruese, duke koordinuar zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinjë.

OST SI
OPERATOR
I RRJETIT
TË TRANSMETIMIT
ËSHTË
PËRGJEGJES
PËR:



1. ASETET E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI

Sistemi Shqiptar i Transmetimit përbëhet nga linjat e transmetimit, nënstationet dhe çdo element tjetër me nivel tensioni nga 110 kV deri në 400 kV.

Më poshtë janë listuar asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit:

• NËNSTACIONE:

1 Nënstacion,

400/220 kV, 600 MVA, (Elbasan2);

1 Nënstacion,

400/220/110 kV, 840 MVA, (Tirana2);

1 Nënstacion,

400/110 kV, 300 MVA, (Zemblak);

1 Nënstacion,

220/110/20 kV, 486 MVA, (Tirana1);

9 Nënstatione,

220/110/MV, 1760 MVA, (Fierzë, V.Dejës, Koplik, Burrel, Elbasan1, Fier, Babicë, Sharrë, Rrashbull);

1 Nënstacion,

150/110 kV, 40 MVA, (Bistrica);

• FUQIA TRANSFORMUESE:

400/220 kV, 1200 MVA;

400/110 kV, 300 MVA;

220/110/20 kV, 440 MVA;

220/110/TM kV, 1920 MVA;

220/20 kV, 126 MVA;

150/110 kV, 40 MVA;

• SHUNT REAKTOR:

220 kV, 120 MVA_r;

• LINJA TRANSMETIMI:

400 kV, 293.6 km;

220 kV, 1150.3 km;

150 kV, 34.4 km;

110 kV, 1586.0 km;

Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar operon në mënyrë sinkrone me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale dhe lidhet me të nëpërmjet linjave të interkonjeksionit:

• Linja 400 kV Tirana 2 – Podgoricë (M.ZI)

• Linja 400 kV Zemblak – Kardia (GR)

• Linja 220 kV Fierzë – Prizren (KS)

• Linja 220 kV Koplik – Podgoricë (M.ZI)

• Linja 150 kV Bistricë – Myrtos (GR)

Garantimi i punës së sigurtë të Sistemit Elektroenergjetik realizohet duke i kushtuar kujdes të veçantë mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit, detyrë që realizohet përmes bashkëveprimit të kordinuar të Njësitëve Operative me Njësinë e Mirëmbajtjes së Transmetimit, që ka në organikën e saj mjetet e rënda dhe specialistët e përgatitur, për ndërhyrje në raste kritike, ose që kërkojnë një profesionalizëm të lartë. Gjithashtu, është e rëndësishme puna për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve, avarive, mangësive që shpreh sistemi i transmetimit. Analizat i të dhënave në mënyrë konstante, na ndihmon për të programuar në kohë dhe me efektivitet ndërhyrjet e nevojshme.


Për cilësinë e punës së Sistemit të Transmetimit janë me rëndësi planifikimet e remonteve, të cilat hartohen në koordinim me përdoruesit e rrjetit dhe kompanitë e transmetimit të rajonit.

Plani i remonteve të pajisjeve primare të nënstationeve, hartohet duke pasur parasysh informacionin e vazhdueshëm për pajisjet, të marrë nga personeli i mirëmbajtjes në Njësitë Operative, si dhe duke respektuar rekomandimet e manualeve të shfrytëzimit të tyre. Ndërsa për sa u takon linjave të tensionit të lartë, plani i remonteve hartohet duke u bazuar në informacionin periodik të ardhur nga sektorët e linjave në Njësitë Operative, dhe nga problematikat e dala në vitet e mëparshme.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të defekteve dhe avarive të Sistemit të Transmetimit, si dhe kohëzgjatjeve të eliminimit të tyre duke u përqendruara në linjat e transmetimit dhe pajisjet transformuese.

STAK MET PËR VIT N 2015

LINJAT	TRANZITORE	TË QËNDRUESHME	PAISJE PRIMARE	KUSHTE ATMOSFERIKE	DIFEKTE LINJE	SHAM/SHAF	LINJAT	MBROJTJA	OSHEE	TË NDRYSHME	STAKIME GJITHSEJ	KOHËZGJATJA
N/stacione	TRANZITORE	TË QËNDRUESHME	PAISJE PRIMARE	KUSHTE ATMOSFERIKE	PROBLEME VAJ APO GAZ	SHAM/SHAF	N/stacione	PERSONEL	PERSONEL	TË NDRYSHME	STAKIME GJITHSEJ	KOHËZGJATJA
Linja 400kV	10	8	0	13	1	0	Linja 400kV	0	0	4	18	11h 05'
Linja 220kV	42	36	5	44	24	0	Linja 220kV	2	0	3	78	137h 20'
Linja 110kV	230	119	27	188	45	9	Linja 110kV	46	17	17	349	469h
Linja gjithsej	282	163	32	245	70	9	Linja gjithsej	48	17	24	445	
N/stacione							N/stacione					
Autotransformatorë	14	24	12	10	2	10	Autotransformatorë	1	0	3	38	70h 25'
Celsa TRR TT	0	2	2	0	0	0	Celsa TRR TT	0	0	0	2	38h 20'
N/stacione gjithsej	14	26	14	10	2	10	N/stacione gjithsej	1	0	3	40	



Tranzitore

Të qëndrueshme

Autotransformatorë Celsa TRR TT

Tranzitore

Të qëndrueshme

* Stakimet në linja dhe nënstatione

Duke krahasuar të dhënat e vitit 2015 me ato të vitit paraardhës nxjerrim përfundimin se, kohëzgjatja e stakimeve të elementeve të rrjetit për vitin 2015, është reduktuar si më poshtë:

- për linjat 400 kV: nga 57 orë në 11 orë
- për linjat 220 kV: nga 284 orë në 137 orë •
për linjat 110 kV: nga 774 orë në 469 orë
- Autotransformatorë: nga 159 orë në

70 orë

Përsa i përket numrit të ndërprerjeve të qëndrueshme nxjerrim përfundimin se, numri i stakimeve të elementeve të rrjetit për vitin 2015 krahasuar me ato të vitit paraardhës është reduktuar si më poshtë:

- për linjat 400 kV: nga 12 në 8 stakime
- për linjat 220 kV: nga 47 në 36 stakime
- për linjat 110 kV: nga 185 në 119 stakime
- Autotransformatorë nga 27 në 24 stakime



2. SISTEMI I MATJES

Gjatë vitit 2015 u realizua dhe u vu në zbatim një projekt shumë i rëndësishëm (Rehabilitimi i Sistemit të Matjes), me qëllim plotësimin e të gjitha kërkesave të ENTSO-E dhe rritjes së sigurisë në matje. Ky projekt pati si qëllim:

- Ndërtimin e QME (Qendra Menaxhuese e Energjisë)** me një platformë të re (Hardware & Software) monitoruese, me qëllim, realizimin e një sistemi matje të hapur dhe me funksione të reja të teknologjive të avancuara të kohës, me aplikime në AMR, AMI, AMM dhe WEB.
- Ndërhyrja në instalacionet** ekzistuese të sistemit të matjes, duke bërë dublimin e matësve ekzistues (referuar Kodit të Rrjetit) dhe përmirësimet e pajisjeve ekzistuese.
- Ndërtimi i infrastrukturës** së komunikimit më të sigurtë, bazuar në rrjetin OPGW të OST sh.a.

3. SISTEMI I MBROJTJES RELE

OST sh.a. tregon një vëmendje të veçantë për mirëmbajtjen e Sistemeve të Mbrojtjes Rele nëpër objektet e Sistemit Energjetik Shqipëtar, për të siguruar punë të dobishme dhe të vazhdueshme, bazuar në kërkesat për sigurinë e lartë të Sistemit Elektroenergjetik Shqipëtar.

Politika e mirëmbajtjes konsiston në monitorimin e vazhdueshëm të sistemit të mbrojtjeve rele në vazhdimësi qoftë nga afër (qasje lokale) ose nga larg (qasje nga distanca), vlerësimin e gjendjes dhe mirëmbajtjen paraprake të tyre, për t'u siguruar që Sistemi Transmetues është gjithmonë i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, në vijim të kërkesave të parashikuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Veprimtaria e Zyrës së Mbrojtjes Rele gjatë vitit 2015 është shtrirë në disa drejtime kryesore, si në:

- Mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes rele në të gjitha nënstationet 400kV dhe 220 kV të sistemit elektroenergjetik.

- Zhvillimin i sistemit të mbrojtjes rele në disa nënstatione të rëndësishme të sistemit, me objekt përmirësimin e skemave të mbrojtjes dhe të komandimit.
- Janë bërë ndryshime në konceptimin e sistemeve të mbrojtjeve rele, duke vënë në efikasitet mundësitë e mëdha të krijuara me instalimin e fibrave optike, pothuaj në të gjitha linjat e sistemit energjetik. Në këtë kuadër, po ndryshon shumë konceptimi i mbrojtjeve të linjave TN dhe po rritet vazhdimisht përdorimi i mbrojtjeve diferenciale të linjave si mbrojtje kryesore në linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV të sistemit energjetik.
- Trajnimi i specialistëve të mbrojtjes rele të grupit Qëndror si dhe të Njësive Operative.
- Gjatë vitit 2015 është shtuar numri i pajisjeve të testimit për pajisjet sekondare, si për grupin qëndror të ZMR ashtu dhe për Njësitë Operative, duke vënë në dispozicion të specialistëve pajisje testimi bashkohore.

4. RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT

Një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm ku OST sh.a. ka investuar, është edhe rrjeti i telekomunikacionit. Për të menaxhuar dhe monitoruar sistemin energjetik, OST sh.a. ka një rrjet telekomunikacioni të shtrirë në të gjithë nënstationet 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, si dhe në të gjithë hidrocentralet e lidhura me sistemin e transmetimit. OST sh.a. menaxhon, mirëmban dhe përfeksionon rrjetin e telekomunikacionit. Në kuadrin e përmirësimit të funksionimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të telekomunikacionit të OST sh.a., gjatë vitit 2015 ka implementuar sisteme të reja me qëllim rritjen e performancës së këtij rrjeti.

Gjithashtu OST sh.a. gjatë vitit 2015, ka bërë të mundur instalimin e 150 km. OPGW që tashmë janë në funksion duke bërë që të realizohen lidhje redudante, rrugë komunikimi të shpejta dhe si rrjedhim,



*Linjë 110 kV, ku është instaluar OPGW

përmirësimin dhe rritjen e performancës së rrjetit të telekomunikacionit, si dhe rritjen e sigurisë së komunikimit dhe marrjes së të dhënave nga nënstacionet e ndryshme të sistemit. OST sh.a. duke vlerësuar telekomunikacionin si një fushë me zhvillim dinamik të madh, ka organizuar me përparësi trajnimin e specialistëve të kësaj fushe.

5. SIGURIA NË PUNË

Aspekt shumë i rëndësishëm që ndiqet në mënyrë të vazhdueshme nga stafi OST sh.a., është siguria në punë dhe zbatimi i Rregullores së Sigurimit Teknik. Për vitin 2015, OST sh.a., kishte objektiva të përcaktuara në kuadër të rritjes së performancës për njohuritë e sigurimit teknik dhe zbatimin e tyre me përpikëri në praktikë. Performanca e OST sh.a. në lidhje me sigurinë në punë është shumë e lartë, ku tregues për të është mospasja e asnjë të aksidentuari në punë.

Gjatë vitit 2015 për njohjen e Rregullores së Sigurimit Teknik, kaluan në testim nga komisioni i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimeve 524 punonjës, të cilët u pajisën me librezë të sigurimit teknik me grupet përkatëse.

Për zbatimin e Rregullores së Sigurimit Teknik në OST sh.a. ushtrohen kontrole periodike


* Pamje gjatë remontit në nënstacion



raport 2015

V. OPERATORI I TREGUT

OST sh.a. luan një rol të rëndësishëm si Operator i Tregut, funksionet e të cilit janë duke u zgjeruar gradualisht me hapat e përcaktuar për krijimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe integrimin e tij në tregun rajonal të energjisë elektrike.



1. REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT

Ky funksion lidhet me zbatimin e procedurave për regjistrimin e subjekteve që dëshirojnë të regjistrohen si palë në tregun shqiptar të energjisë, hartimin dhe administrimin e Regjistrimit të Palëve të tregut, me të dhënat përkatëse të subjekteve të regjistruara si dhe plotësimin në vijimësi të kushteve përkatëse të tyre për të qëndruar palë në treg.

Janë ndjekur në vijimësi të gjitha kërkesat e paraqitura nga subjektet, për t'u regjistruar në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me licencat përkatëse të emetuara nga ERE.

Deri në fund të vitit 2015, rezultojnë të regjistruara 30 subjekte, zotërues të 53 licencave në treg, prej të cilëve:

- 20 janë Furnizues,
- 25 janë Tregtues,
- 8 janë Prodhues.

2. NJOFTIMI I KONTRATAVE

Të gjithë transaksionet e tregut shqiptar të energjisë, të rregulluara nga ERE ose jo, duhet të njoftohen në OT, në formën e njoftimit të kontratave apo transfertave të aplikuara dhe pranuar të palëve të tregut. Është OT hallka që nominon këto kontrata, certifikon vlefshmërinë e tyre, sipas procedurave përkatëse të fiksuara në Rregullat e Tregut. Për të gjithë transaksionet e nominuara, OT administron një regjistër, në të cilin janë mbajtur llogaritë përkatëse të palëve, për transaksionet e kryera në treg.

Janë regjistruar në vijimësi të gjithë Njoftimet e Kontratave dhe transfertave të transaksioneve të palëve të tregut në shitjen, blerjen, importin dhe eksportin e energjisë elektrike.

Nga ky regjistër rezulton se, të njoftuara nga palët, janë regjistruar:

- Në tërësi 559 kontrata (me volum të përgjithshëm 6'314'816 MWh), nga të cilat:
 - Export 166 kontrata (me volum të përgjithshëm 966'799 MWh),
 - Import 153 kontrata (me volum të përgjithshëm 2'290'747 MWh),
 - Furnizim i Klientëve të lidhur në Sistemin e Transmetimit janë 61 kontrata (me volum të përgjithshëm 633'240 MWh),
 - Ndërmjet Palëve të Tregut 180 kontrata (me volum të përgj. 2'423'990 MWh)

Kontrata me pikë lëvrimit në kufi janë regjistruar:

- Në tërësi 319 kontrata (me volum të përgjithshëm 2'783'639 MWh), nga të cilat:
 - "Hyrje në ST", 141 kontrata (me volum të përgjithshëm 1'762'721 MWh),
 - "Hyrje nga SEE", 178 kontrata (me volum të përgjithshëm 1'020'918 MWh)

3. NOMINIMI I KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT

OST sh.a. administron kapacitet transmetues në interkonjeksione duke aplikuar rezervimin e të drejtës së transmetimit fizik nëpërmjet ankandeve, sipas Rregullave për Alokimin e Kapaciteteve në Interkonjeksione. Për këto ankande, OT administron një regjistër në të cilin janë regjistruar të dhënat e ofertave të palëve në ankand, si edhe të ofertave fituese në këto ankande.

Janë regjistruar në vijimësi të drejtat e transmetimit fizik të palëve të tregut në interkonjeksione, sipas kufirit, drejtimit të fluksit dhe periudhës rezervuese, për të gjithë kapacitetet, vjetore dhe mujore, të fituara në ankandet e ATC të organizuara nga OST.

Në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve në Interkonjeksione, palët e tregut kanë nominuar kapacitetet në interkonjeksion që do të përdorin në ditën e operimit D, brenda afatit të përcaktuar (deri në ora 10:00 të ditës D-2).

Bazuar në këto nominime, janë përcaktuar kapacitetet disponibël në interkonjeksion për alokim ditor, dhe janë zhvilluar ankandet ditore, për çdo kufi dhe drejtim, për të cilin kanë rezultuar kapacitete transmetuese disponibël.

4. ALOKIMI I KAPACITETEVE NË INTERKONJEKSIONE

Në lidhje me alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, për vitin 2015 janë ndjekur procedurat përkatëse, sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendim nr. 140 datë 22/11/2013 “Rregullore mbi alokimin e kapacitetit në Interkonjeksione”

Në përputhje me këto vendime të ERE-s, janë zhvilluar ankandet vjetore, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015 (për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë) dhe ankandet mujore (për kufirin me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë) për çdo muaj, si edhe ankandet ditore për çdo ditë.

- **Në ankandin vjetor, I paraqitën ofertat e tyre 7**

Në ankand janë paraqitur dhe vlerësuar gjithsej 133 oferta, me një kapacitet prej 8'795'040 MWh, dhe vlerë të përgjithshme të ofertave 18'674'041 Euro.

Kanë rezultuar fituese në ankand 49 oferta, me një kapacitet prej 3'066'000 MWh, me një vlerë të përgjithshme prej 7'735'920 Euro.

Konstatohet se kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë e shprehur e balancuar, pothuaj njëjloj për drejtimin import (53.4%) dhe eksport (46.6%).

Në përfundim të procedurës së ankandit nuk ka patur asnjë rezervë të shprehur të pjesëmarrësve, për procedurat dhe rezultatet e ankandit.

- **Në ankandet mujore të zhvilluara nga OST-ja, nga 30 pjesëmarrësit e tregut të regjistruar tek OT, kanë marrë pjesë 14 subjekte.**

Në ankand janë paraqitur dhe vlerësuar 1'659 oferta, me një kapacitet prej 15'458'036 MWh, me një vlerë të përgjithshme të ofertave 32'518'456 Euro.

Kanë rezultuar fituese në ankand 616 oferta, me një kapacitet prej 6'610'33 MWh, me një vlerë të përgjithshme prej

13'031'011 Euro.

Janë fituar pa konxhestion, me çmim 0.00 Euro/MWh, 46 oferta, me një kapacitet prej 400'386 MWh
Çmimi maksimal i ofertave të paraqitura është 40 Euro/MWh, çmimi maksimal i ankandit ka rezultuar 16.03 Euro/MWh

Çmimi minimal i ofertave të paraqitura është 0.01 Euro/MWh (sa lejojnë rregullat përkatëse të alokimit), çmimi minimal i ankandit ka rezultuar 0.00 Euro/MWh (kur nuk rezulton konxhestion në ankand)

- **Ankandet ditore**, në mungesë të Softit të Operimit të Tregut, për zhvillimin e ankandëve Ditore është përdorur nga OST sh.a. platforma elektronike NOVITA.

Për muajin Maj 2015 e në vijim, edhe alokimi ditor i kapaciteteve në interkonjeksion për kufirin me Malin e Zi, është zhvilluar në SEE CAO.

Në përputhje me Vendimin nr. 61 datë 07/07/2014 të ERE-s, janë hedhur nga OT në ankand ditor, kapacitetet e pa alokuara në ankandin vjetor, kapaciteti i pa alokuar në ankandin mujor të radhës si edhe kapacitetet “e lira”, të cilat nuk janë nominuar në (D-2) nga palet e tregut.

Në tërësi, janë alokuar me konxhestion në ankandet ditor, të zhvilluar nga OST, 20'776 MW (498'624 MWh) me një çmim mesatar rreth 0.065 Euro/MWh dhe vlera vjetore e ATC të alokuara në ankandet ditore të OST është 32'604 Euro.

Nga alokimi ATC ditore në SEE CAO, vlera vjetore për OST është 4'898 Euro.


Pra, në tërësi, vlera vjetore e alokimit ditor të ATC për OST është 37'502 Euro

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar nga komisioni përkatës i OST-së, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, si edhe udhëzimet apo vendimet përkatëse të ERE-s.


Vlen të theksojmë në këtë drejtim se nuk ka pasur asnjë reklamim, rezervë apo kundërshtim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

Duke vlerësuar se implementimi i Tregut të Energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjellët, ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut sipas rolit përkatës të tyre në Tregun e Energjisë, OT vijon takimet dhe konsultimet e herëpashershme me Pjesëmarrësit e Tregut. Është realizuar rregullisht dhe në përputhje me afatet përkatëse detyruese informimi periodik i OST tek ERE për ankandet e zhvilluara të ATC si dhe publikimi i rezultateve sipas kërkesave në faqen e internetit të OST sh.a.


TË ARDHURAT NGA ANKANDET E VITIT 2015



TË ARDHURAT NGA ANKANDET E VITIT 2015



IMPORTI 2015 SIPAS KATEGORIVE



5. DISBALANCAT


Në vijim të praktikave të përdorura dhe në zbatim të ndryshimeve të Rregullave të Tregut nga ana e ERE-s, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-s, janë kryer llogaritjet e disbalancave për secilin Pjesëmarrës Tregu, në bazë orare.

Në mënyrë periodike janë informuar Palët për disbalancat e kryera në mënyrë që të planifikojnë kompensimet përkatëse. Janë vlerësuar disbalancat e Palëve në bazë mujore, që me pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut. Po kështu, në bazë mujore janë llogaritur dhe është kompensuar edhe KESH sh.a. për shërbimin e balancimit të sistemit të transmetimit.


Në grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e përgjithshme të volumeve të shmangieve brenda tolerancës prej $\pm 2\%$ të Pjesëmarrësve të Tregut, për periudhën Janar - Dhjetor 2015.

Disbalancat në këta kufi nuk penalizohen në vlera monetare por kompensohen nga të dy palët në energji.

DISBALANCAT BRENDË ZONËS $\pm 2\%$




DISBALANCAT BRENDA ZONËS ± 2%




6. SHËRBIMI I TRANSMETIMIT

OST aplikon tarifën e transmetimit sipas çmimit të miratuar nga ERE, mbi përdorimin e sistemit të transmetimit nga Pjesëmarrësit e Tregut.

TË ARDHURA NGA TARIFA E TRANSMETIMIT NË MILION LEKE



TARIFA E TRANSMETIMIT 2015



7. SHËRBIMET NDIHMËSE

Për sa i përket Shërbimeve Ndihmëse në sistemin e transmetimit vlen të përmendet se gjatë vitit 2015 kanë vijuar përpjekjet në procesin e hartimit të kuadrit rregullator.

ERE, me vendim nr. 141, datë 26.12.2014 miratoi Tarifën për Shërbimet Ndihmëse që aktualisht ofrohet vetëm nga Gjeneruesi Publik KESH sh.a. Deri në krijimin e një tregu të shërbimeve ndihmëse, sigurimi i tyre si dhe i energjisë balancuese për balancimin e sistemit elektroenergjetik, do të realizohet me çmim të rregulluar sipas marrëveshjes me KESH sh.a. të muajit shkurt, 2015.

8. TRANSPARENCA DHE PUBLIKIMET

Transparenca është aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së OT.

Faqja web e OT është pjesë e asaj të OST sh.a., në të cilën janë publikuar:

- të dhëna mbi legjislacionin për Tregun e Energjisë, si Ligji për Sektorin e Energjisë, Modeli i Tregut, Rregullat e Tregut, Formatet e kontratave tip të miratuara, Vendime të ERE-së etj;
- të dhëna mbi regjistrimin në OT, si procedura e regjistrimit, formatet përkatëse të regjistrimit, lista e palëve të tregut;
- të dhëna mbi ankandet e kapaciteteve në interkonjeksione, si njoftimet për ankandet vjetore dhe mujore, rezultatet e këtyre ankandëve;
- njoftime të disallojshme, që kanë të bëjnë me operimet e ndryshme, të tilla si çmimet për imbalancat etj.

Të dhënat qendrojnë të publikuara, periodikisht të azhuruara.

OT publikon edhe informacione të tjera, lidhur me operimet e Tregut të Energjisë Elektrike, procedurat e aplikuara në treg, kontrata tip apo formate dokumentesh.

Ndër objektivat kryesore të mbështetura nga OST sh.a. është bashkëpunimi rajonal, pjesëmarrja në grupet rajonale të punës, në mbështetje të direktivave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike dhe Sekretariatit të Vjenës.

Implementimi i kontratës së operimit të platformës elektronike për Operimin e Tregut, mbetet ndër përparësitë e punës të DOT. Kontrata, do të shërbejë për arritjen e një niveli bashkëkohor të komunikimit të Pjesëmarrësve të Tregut me OT, do të rrisë volumet dhe cilësinë për informacionet e nevojshme për Operimin e Tregut në mënyrë korrekte dhe transparente si dhe do të rrisë performancën e operimit të tregut dhe shmangien e gabimeve të mundshme në përlllogaritjen e faturave dhe proceseve të punës së DOT.

Operatori i tregut ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm lidhur me detyrat që dalin nga zbatimi i Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të cilat kushtëzojnë përmirësimin dhe fuqizimin organizativ të OT për të përgatitur ndarjen financiare dhe ligjore të saj siç parashikohet në ligjin e sektorit.

Po në këtë prizëm nga ana e OT në bashkëpunim me MEI dhe pjesëtarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike, dhe me supervizimin dhe konsulencën e Sekretariatit të Vienës, është bërë pjesë përbërëse aktive e Steering Committee për ndryshimin dhe miratimin e akteve nënligjore që lindin nga zbatimi i ligjit të sektorit siç janë: Modeli i tregut, Rregullat e tregut, Rregullat e balancimit, Rregullat e blerjes së humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse etj.


Një ndër fushat e zhvillimit të sektorit në një të ardhme të afërt, është dhe krijimi i Bursës së Energjisë Elektrike në të cilën OST sh.a. pritet të jetë aksioneri kryesor. Në këtë prizëm Steering Committee, ngritur nën drejtimin e MEI pjesë aktive e së cilës është dhe OT, është duke punuar gjerësisht me të gjithë pjesëtarët e tregut për krijimin e kushteve, masave dhe hapave ligjore dhe teknike që duhen ndërmarrë për krijimin dhe funksionimin e suksesshëm të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sipas praktikave më të mira Evropiane dhe bashkimin me Tregun Panevropian në mbështetje të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare që lindin nga Procesi i Berlinit.

raport 2015

VI. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

OST sh.a. zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, planeve të zhvillimit për burime të reja të energjisë elektrike, dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur struktura e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar:



*Struktura e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar

Përfitimet më të rëndësishme të projekteve të reja janë: reduktimi i energjisë së pafurnizuar dhe ulja e humbjeve në transmetim. Nga viti 2005 deri në vitin 2015 kërkesa për energji elektrike është rritur me 35%, ndërsa humbjet e energjisë elektrike janë ulur nga 4,56% në 2,03%.


Ndërkohë, janë në fazën e implementimit projekte të rëndësishme dhe OST sh.a. ka një plan të qartë për Zhvillimin e Sistemit të Transmetimit.

1. PROJEKTET KRYESORE TË REALIZUARA

a) Përforsimi i rrjetit të transmetimit 110 kV i Jugut të Shqipërisë.

Projekti është një investim i Qeverisë Gjermane, financuar nga Banka KfW, 49 mil.€, që përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re 110 kV Babicë – Sarandë, 104 km;
- Ndërtimin e linjës së re 110 kV Ersekë – Përmet, 55.7 km;
- Rikonstruksionin e linjës 110 kV Korçë – Ersekë, 39 km;
- Rikonstruksionin e linjave 110 kV Përmet – Këlcyrë – Memaliaj, 39 km;
- Plotësimin e qarkut të dytë të linjës 110 kV Zemblak - Korçë, 13.4 km.
- Fuqizimin e nënstacionit Zemblak, 50 MVA.



*Harta e Jugut të Shqipërisë

b) Ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrat Qendrore të OST sh.a.

Projekti financohet nga Kooperacioni Italian, 23 mil. €, dhe konsiston në ndërtimin e godinës së Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrate Qendrore të OST sh.a. si dhe ngritjen e një sistemi të ri SCADA/EMS me të gjithë funksionet e tij. Projekti ka përfunduar dhe sistemi SCADA/EMS është në funksionim të plotë, ndërkohë në Nënstacionin 400 kV Tirana 2 është instaluar sistemi Backup për SCADA/EMS. Godina e re e Qendrës së re Kombëtare Dispeçer ka përfunduar në vitin 2015.

*Projekti i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer dhe Zyrate Qëndrore të OST

Na duhet foto e projektiti te godines me rezolucion me te mire



c) Linja 110 kV Peshkopi – Lapaj.

Projekti financohet me fondet e OST, 3.4 mil.€ dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 110 kV Peshkopi – Lapaj, 27.2 km;
 - Zgjerimin e nënstacioneve Peshkopi dhe Lapaj me dy dalje të reja 110 kV respektive.
- Projekti ka përfunduar në vitin 2015 dhe linja është e gatshme për të operuar.

*Shtritja e përcjellësit



d) Linja 110 kV Uznovë – Çorovodë.

Projekti financohet me fondet e OST, 3.89 mil.€ dhe përfshin:

- Ndërtimin e qarkut të parë të linjës së re ajrore 110 kV me dy qarqe Uznovë - Çorovodë, 33 km;
- Zgjerimin e nënstacionit Uznovë me një dalje të re 110 kV.

Projekti ka përfunduar në vitin 2015 dhe linja është e gatshme për t'u vënë në punë.

*Shtyllë me dy qarqe e linjës



e) Instalimi i Trosit Optik (OPGW) në linjat e transmetimit.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 0.98 mil.€ dhe përfshin kompletimin me 150 km me tros optik të linjave të mëposhtme:

- Linja 220 kV V.Dejës – Koplík (kufi)
- Linja 110 kV Lezhë – Bushat
- Linjat 110 kV Laç 2 – Lezhë – Skuraj – Laç 1
- Linja 220 kV Tirana 2 – Sharrë
- Linja 220 kV Tirana 1 – Elbasan 1
- Linja 220 kV Elbasan 1 – Elbasan 2
- Linja 110 kV Babicë - Selenicë

Projekti ka përfunduar në muajin shtator të vitit 2015.

*Shtrirja e Trosit Optik



2. PROJEKTET NË PROCES IMPLEMENTIMI

a) Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Kosovë.

Projekti është një investim i Qeverisë Gjermane, financuar nga Banka KfW, 42 mil.€ pjesa Shqiptare dhe përfshin:

- Zgjerimin e nënstacionit Tirana 2 dhe instalimin e një Shunt-Reaktori 120 MVAR;
- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV Tirana 2 – Kosova B.

Gjatësia e plotë e linjës është 242 km. Pjesa që kalon në territorin Shqiptar është 151.5 km, ku 80 km e parë përfshijnë plotësimin e qarkut të dytë të linjës Tiranë-Podgoricë, nga Tirana në Laç Qyrsaq dhe 71,5 km linjë e re me një qark deri në kufi.

Projekti është në fazën e implementimit dhe linja parashikohet të vihet në punë në fillim të vitit 2016.

*Shtrirja e Trosit Optik



b) Linjë e re 110 kV me dy qarqe Rrashbull - Kavajë.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 2.2 mil.€ dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore me dy qarqe 110 kV Rrashbull – Golem - Kavajë, 19 km; Përcjellësi i linjës do të jetë material Alumin/Çelik me seksion 240/4 mm², ku fillimisht do të plotësohet vetëm një qark i linjës.

Projekti është në fazë implementimi dhe linja parashikohet të vihet në punë në muajin Korrik 2016.

c) Linjë e re 110 kV me dy qarqe Ulëz-Skuraj.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 0.95 mil.€ dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore me dy qarqe 110 kV Ulëz-Shkopet-Skuraj, 8.7 km; Përcjellësi i linjës do të jetë material Alumin/Çelik me seksion ACSR-240/40 mm², dhe linja do të plotësohet me të dy qarqet.

Projekti është në fazë implementimi dhe linja parashikohet të vihet në operim brenda vitit 2016.



d) Instalimi i dy Autotrasformatorëve të rinj 60 MVA në Nënstacionin e Burrelit.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 1.7 mil.€ dhe përfshin:

- Instalimin e dy Autotransformatorëve të rinj 220/110/10 kV me fuqi 60 MVA secili; Autotransformatorët e rinj do të kenë të instaluar Rregullatorët Automatik të Tensionit në ngarkesë dhe përshtjellë terciale me tension 10 kV për furnizimin e rajonit që përfshin qytetin, fshatrat dhe uzinën e Ferro-Kromit.

Projekti është në fazë implementimi dhe Autotransformatorët parashikohen të vihen në punë në muajin Qershor 2016.

e) Instalimi i një Platforme Elektronike për Operimin e Sistemit dhe Operatorin e Tregut.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 1.34 mil.€ dhe përfshin:

- Instalimin e një platforme ku do të kryhen këto funksione kryesore: •
Alokimi i kapaciteteve të linjave të interkonjeksionit
- Njoftimet kontraktuale
- Skedulimi i brendshëm dhe llogaritja e shkëmbimit ndërkufitar
- Menaxhimi i të dhënave të energjisë
- Arshivimi i të dhënave dhe raportimi
- Mekanizmi i balancimit
- Shërbimet ndihmëse
- Shkëmbim i të dhënave direkte me platformën e transparencës së ENTSO-E

Projekti është në fazë implementimi dhe Platforma Elektronike parashikohet të vihet në punë në vitin 2017.

3.PROJEKTE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT SHQIPTAR TË TRANSMETIMIT ENERGJETIK

a) Linja 220 kV me dy qarqe Tirana 2 - Rashbull dhe fuqizimi i nënstacionit të Rashbullit.

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e një linjë të re 220 kV me dy qarqe, Tirana 2 - Rashbull, rreth 18 km. dhe dy dalje linje të reja 220 kV në nënstacionet respektive.
- Fuqizimin e nënstacionit 220/110 kV Rashbull, 2x150 MVA.

PËRFITIMET:


- Ky projekt është shumë i rëndësishëm për Sistemin Kombëtar të Transmetimit, sepse zgjidh probleme të tilla si: mbingarkimin e linjës ekzistuese, përmbushjen e kriterit të sigurisë N-1, uljen e humbjeve në transmetim dhe të energjisë së pafurnizuar.
- Përmirëson furnizimin me energji elektrike në një rajon shumë të gjerë, që përfshin rrethin e Durrësit, Kavajës duke dhënë një impakt pozitiv në të gjithë zonën jugore të Shqipërisë;
- Përbush të gjitha kërkesat e legjislacionit Shqiptar dhe Evropian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- Do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë e përgjithshme dhe në përmirësimin e mënyrës së jetës ßëpullsinë shqiptare;
- Do të rrisë mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit pasi do të përmirësohet furnizimi me energji elektrike;

Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës KfW. Në vitin 2016 OST do të bëjë përzgjedhjen e kompanisë konsulente.


b) Përforcimi i rrjetit unazor 110 kV të Tiranës dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3.

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3, 2x150 MVA.
- Demontimin e linjave ajrore ekzistuese 110 kV Tirana 1 - U.Traktori, U.Traktori - Selitë, dhe ndërtimin e linjave të reja 110 kV (afërsisht 17 km. linjë ajrore me përcjellës ACSR-300 mm² dhe 7 km. linjë kablllore me përcjellës XLPE-1000 mm²).



*Diagrama një-fazore Tirana 2 - Rashbull



*Diagrama një-fazore e rrjetit unazor 110 kV të Tiranës.

PËRFITIMET:

- Tranzitim të flukseve të energjisë nga rrjeti 400 kV i interkonjeksionit në rrjetin kombëtar 110 kV;
- Rritje të sigurisë së operimit të sistemit;
- Cilësi më e lartë e furnizimit me energji elektrike si dhe rritja e besueshmërisë së furnizimit për rajonin e Tiranës;
- Ulje të humbjeve në rrjetin e transmetimit;
- Ulje të energjisë së pafurnizuar;
- Projekti përmbush të gjitha kërkesat e legjisllacionit Shqiptar dhe atij Evropian për mbrojtjen e mjedisit;

Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI/IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës KfW. Gjatë vitit 2016 OST do të bëjë përzgjedhjen e kompanisë konsulente.

c) Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri - Maqedoni dhe zgjerimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 2.

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 - Bitola, afërsisht 151 km, 56 km. të së cilës në territorin Shqiptar.
- Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan 2 me dy zbara dyfishe 400 kV, një dalje të re linjë 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVAR.



*Harta e linjës 400 kV Elbasan - Bitola

PËRFITIMET:

Zhvillimin e rrjetit ekzistues duke mbyllur unazën 400 kV midis Shqipërisë – Maqedonisë – Greqisë;

- Përmirësimin e kapacitetit të rrjetit për t'iu përshtatur ngarkesës së parashikuar, dhe rritjes së tranzitit, si dhe mundësisë së lidhjes së gjeneruesve të rinj, duke përmirësuar kapacitetin transmetues në Shqipëri, Maqedoni, dhe në rajonin e Ballkanit në përgjithësi;
- Përmirësimin e besueshmërisë së rrjetit rajonal, sigurisë së përgjithshme të furnizimit, dhe fleksibilitetit në operimin e sistemit elektroenergetik;
- Uljen e humbjeve në sistemin e transmetimit;
- Përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (normalizimi i niveleve të tensionit,


- stabilizimi i shpërndarjes së flukseve të fuqisë dhe luhatjet e frekuencës, etj.);
- Mbështet zhvillimin e tregut rajonal të energjisë në Evropën Juglindore dhe krijimin e mundësive tregtare me Bullgarinë dhe Italinë;
 - Mbështetje e ndërsjellë midis Maqedonisë dhe Shqipërisë për shkak të diversitetit të gjenerimit të energjisë elektrike (Shqipëria- Hidro, Maqedonia- Termo);
 - Uljen e kostos së sigurimit të kapaciteteve rezervë, si dhe ofrimin e mbështetjes reciproke emergjente.

Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. OST dhe MEPSO (MK) kanë ngritur grupe të përbashkëta pune për ta ndjekur këtë projekt.

d) Linja e Transmetimit 400 kV Elbasan 2 - Fier

Rajoni i Fierit do të shndërrohet në një pikë shumë të rëndësishme për lidhjen në të ardhmen e burimeve të rinj gjenerues të energjisë elektrike, nga termocentralet me gaz dhe hidrocentralet e kaskadës së Lumit Vjosa. Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 – Fier, rreth 74 km, si dhe dy dalje linje 400 kV në nënstationin Elbasan 2 dhe nënstationin Fier.
- Zgjerimin e nënstationit 220 kV Fier, 1x400 MVA dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit.



PËRFITIMET:

- Përmirësimi i standardeve të përgjithshme, besueshmërisë, cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të Shqipërisë;
- Reduktimi i humbjeve në transmetim (ulja e kostos së furnizimit) në zonën qendrore dhe jugore të rrjetit 220 kV;
- Ulje e energjisë së pafurnizuar për rreth 400,000 konsumatorë;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në aspektin ekonomik dhe shoqëror;
- Nxitja e zhvillimit ekonomik të rajonit qendror të Shqipërisë si pasojë e furnizimit më të mirë me energji elektrike dhe uljes së kufizimeve të ngarkesës;
- Ulje e mbingarkimit të rrjetit 220 kV.

Studimi i fizibilitetit të projektit, të financuar në kuadrin e WBIF, është përgatitur nga konsorciumi Mott Mac Donald/IPF.

Për këtë projekt dhe atë të mësipërm, OST ka përfunduar fazën e marrëveshjes me Bankën Gjermane KfW, që ka shprehur interes në financimin e të dy projekteve (Linja e Interkonjeksionit 400 kV Fier-Elbasan dhe Elbasan-Kufi) në një paketë të përbashkët financiare.

Komuniteti Evropian do të mundesojë një grand, si pjesë e këtij projekti.

raport 2015

VII. PASQYRAT FINANCIARE

OST sh.a. hartoi Pasqyrat Financiare për vitin 2015 të cilat u audituan nga një kompani auditimi e pavarur (KPMG Albania shpk). Sipas raportit të lëshuar nga audituesit e pavarur, Pasqyrat Financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar më datën 31 Dhjetor 2015, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar duke mundësuar që opinionin e audituesve të jetë i pakualifikuar.

1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

OST sh.a. ka bërë riparaqitje për periudhat krahasuese si me 01 Janar 2014 dhe 31 Dhjetor 2014, për të paraqitur në mënyrë retrospektive ndryshimin në politikën kontabël për transferimin e shumës së rezervës së rivlerësimit, si dhe efektin e vlerësimit me vlerën e drejtë të huave afatgjata në momentin fillestar dhe mbajtjen e tyre me kosto të amortizuar.

pasqyrat e pozicionit financiar për vitin 2015

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë)

AKTIVET

Aktivitet afatgjata

Aktivitet afatgjata materiale	50,943,269	42,252,127	39,406,674
Aktivitet afatgjata jomateriale	85,637	49,489	52,610
Të arkëtueshme tregtare	1,354,463	2,090,750	-
Aktive financiare të arkëtueshme	15,201	17,957	117,081

52,398,570

44,410,323

39,576,365

Aktive afatshkurtra

Parapagime për furnitorë	190,661	1,437,187	2,073,547
Inventarët	711,040	905,163	907,373
Të arkëtueshme nga klientë dhe aktive të tjera	8,195,110	7,631,746	6,818,595
Aktive financiare të arkëtueshme	5,133	104,557	152,611
Mjete monetare në arkë e bankë	612,673	1,257,653	467,866
Tatimi i parapaguar mbi fitimin	43,468	-	22,530

9,758,085

11,336,306

10,442,522

TËRËSIA E AKTIVEVE

62,156,655

55,746,629

50,018,887

KAPITALI Kapitali

aksionar Rezerva të tjera	9,694,008	9,694,008	9,694,008
Rezerva e rivlerësimit	2,936,205	3,067,454	1,737,442
Rezerva ligjore Fitime të mbartura	10,651,362	8,651,539	9,237,519
	537,510	443,028	364,792
	4,760,174	3,092,491	2,196,852

TËRËSIA E KAPITALIT

28,579,259

24,948,520

23,230,613

DETYRIME

Detyrime afatgjata

Huatë	22,579,082	20,715,918	18,779,942
Grante qeveritare	620,114	591,281	659,906
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	971,116	491,620	404,502
Provizione	-	1,183,990	-
Detyrime të shtyra tatimore	1,439,993	1,453,877	1,550,348

25,610,305

24,436,686

21,394,698

Detyrime afatshkurtra

Huatë	4,329,813	3,371,679	2,845,303
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	3,637,278	2,949,525	2,548,273
Detyrime për tatimin mbi fitimin	-	40,219	-

7,967,091

6,361,423

5,393,576

TËRËSIA E DETYRIMEVE

33,577,396

30,798,109

26,788,274

TËRËSIA E KAPITALIT DHE DETYRIMEVE

62,156,655

55,746,629

50,018,887

pasqyra e fitimit/humbjes për vitin 2015

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë)	2015	2014 (riparaqitur)
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	6,092,990	6,718,152
Të ardhura të tjera	255,937	169,142
	6,348,927	6,887,294
Materiale në përdorim dhe konsum	(101,430)	(76,196)
Kosto transmetimi	(513,575)	(392,459)
Shpenzime personeli	(1,020,194)	(993,115)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	(1,629,916)	(1,613,960)
Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	(1,456,786)	-
Shpenzime për provizione	-	(987,596)
Shpenzime të tjera	(391,983)	(204,876)
FITIMI OPERATIV	1,235,043	2,619,092
Të ardhura financiare neto	256,654	(78,828)
Shpenzime interesi	(289,642)	(283,194)
KOSTO FINANCIARE NETO	(32,988)	(362,022)
FITIMI PARA TATIMIT	1,202,055	2,257,070
Tatimi mbi fitimin	34,088	(445,336)
FITIMI I VITIT	1,236,143	1,811,734

